

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

URDHRI I FARMACISTËVE

KËSHILLI KOMBËTAR

Nr. 73/6 Prot.

Tiranë, më 26/01/2024

VENDIM

Nr. 7, datë 26.01.2024

Për një ndryshim në Vendimin Nr. 13, datë 23.12.2019 të Këshillit Kombëtar

Në mbështetje të nenit 11, pika 4, neni 13, të Ligjit Nr. 9150, datë 30/10/2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 25, pika 2, pika 5, të “Statutit të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë”, në mbledhjen e datës 26.01.2024 Këshilli Kombëtar,


Vendosi:

- 1- Anëtarët e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë të cilët nuk e kanë ushtruar profesionin e farmacistit për një periudhën prej më shumë se 5 (pesë) vjetësh dhe kërkojnë të ushtrojnë profesionin në Farmaci, duhet t’i nënshtrohen një praktike profesionale 3 (tre) mujore në farmaci. Në përfundim të praktikës do i nënshtrohen një testimi të organizuar pranë Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, për sa i përket aspektit legjislativ në sektorin farmaceutik.
- 2- Përfshihen nga ky detyrim farmacistët të cilët gjatë periudhës që nuk kanë ushtruar profesionin e farmacistit, kanë qenë të angazhuar në një nga veprimtaritë e mëposhtme:
 - Kanë ushtruar funksione administrative drejtuese në organe shtetërore në profilin farmaceutik;
 - Kanë punuar në institucione publike në profilin farmaceutik;
 - Kanë kryer specializime apo studime pasuniversitare në profilin e shkencave farmaceutike, brenda ose jashtë vendit;
 - Kanë qenë të angazhuar në mësimdhënie në profilin e shkencave farmaceutike;
 - Kanë ushtruar profesionin e farmacistit jashtë vendit, vërtetuar kjo me dokumentacionin përkatës.

- 3- Miratimin e tarifës 10 000 lekë për anëtarët që do i nënshtrohen praktikës profesionale 3 (tre) mujore.
- 4- Miratimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin për kryerjen e praktikës profesionale 3 (tre) mujore në farmaci, sipas lidhjes Nr. 1, bashkëlidhur.
- 5- Urdhri i Farmacistëve pajis me vërtetim anëtarët të cilët do t'i nënshtrohen praktikës profesionale 3 (tre) mujore në farmaci.
- 6- Anëtarët e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë të cilët nuk e kanë ushtruar profesionin e farmacistit për një periudhën prej më shumë se 5 (pesë) vjetësh dhe kërkojnë të ushtrojnë profesionin në, importues dhe shpërndarës farmaceutik, prodhues farmaceutik, përfaqësi farmaceutike apo institucione publike ose në sektorë të tjerë shëndetësorë, i nënshtrohen praktikës profesionale në Farmaci, nëse e ushtrojnë profesionin e farmacistit në një nga subjektet e sipër përmendura për më pak se 3 (tre) muaj, nga momenti i rikthimit.
- 7- Pika 2 dhe 3 e vendimit Nr. 13, datë 23.12.2019 të Këshillit Kombëtar, shfuqizohen.
- 8- Ky vendim hyn në fuqi më datë 01.02.2024.

PRESIDENT

Defrim GOMA



Lidhja Nr. 1

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR KRYERJEN E PRAKTIKËS PROFESIONALE NË FARMACI, PAS 5 VITE SHKËPUTJE

Çdo farmacist që do të rikthehet të ushtrojë profesionin në Farmaci pas pesë vite shkëputje dhe do t'i nënshtrohet praktikës profesionale 3 (tre) mujore në Farmaci, duhet të paraqitet personalisht pranë zyrave të UFSH-së me dokumentat e mëposhtme:

- Kërkesë;
- Vetëdeklarim;
- Kontratë tip për kryerjen e praktikës profesionale;
- Fotokopje e certifikatës anëtarësimit në UFSH të drejtuesit të praktikës;
- Raport mjeko-ligjor;
- Mandat pagesën në shumën 10000 lekë, në numrin e llogarisë 69623 pranë bankës BKT;
- Fotokopje e kartes së identitetit.